

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6320
E martë, 25 maj 2021
çmimi 0.40 €

Kurti: Të ndalet fushata e pasivizimit të adresave në Luginë të Preshevës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

REPUBLIKA E KOSOVËS KA SHËNUAR 24 MAJIN - "DITËN E PRESIDENTIT" | FAQE 4-5

NË 'DITËN E PRESIDENTIT' KËRKOHEM UNITET NGA SPEKTRI POLITIK



Në "Ditën e Presidentit", ish-presidentët Fatmir Sejdiu dhe Atifete Jahjaga kanë kërkuar unifikim të spektrit politik për t'u përballur me sfidat me të cilat është duke u ballafaquar Kosova. Sipas tyre, vetëm të

bashkuar dhe me vullnet të artikuluar Kosova mund t'i kalojë proceset e rëndësishme. Për nder të kësaj dite, presidentja Vjosa Osmani, së bashku me ish-presidentët Sejdiu, Pacolli e Jahjaga, kanë bërë homazhe te

shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova, ku kanë vlerësuar lart rolin dhe kontributin e tij. Asnjëri prej këtyre nuk e ka përmendur ish-presidentin Hashim Thaçi i cili ndodhet në paraburgim në Hagë



AMBASADORI AMERIKAN: SHBA-ja KËRKON ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË UASHINGTONIT, BIDENI E DI RËNDËSINË E BALLKANIT | FAQE 3

OPINION

TENSIONIM I PANEVOJSHËM NË KAMENICË, KOMUNA KA PËRGJEGJËSI PËR ARSIM! F. 10

Reagim i KMDLNj-së

AKTUALE



PËRKUJTOHEN DËSHMORËT E BATALIONIT "SHKELZEN HARADINAJ" F. 7

NJË I VDEKUR, 93 TË SHËRUAR DHE 14 RASTE TË REJA ME COVID F. 6

OKMF-JA NË SUHAREKË OFRON SHËRBIME TË PEDIATRISË F. 10

EKONOMI

THELLOHET DEFICITI TREGTAR NË KOSOVË F. 9

SOT PROTESTOJNË GASTRONOMËT F. 9

DËRGESAT E DIASPORËS NË SHOIPËRI ARRITËN NË 1.5 MILIARD DOLLARË, MË TË ULËTAT NË RAJON GJATË VITIT 2020 F. 8

SPORT

ISLAMI LARGOHET NGA FERONIKELI, ARRIN MARRËVESHJE ME DITËN F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Katër kandidatë në garë për kryetar të PD-së

TIRANË, 24 MAJ - Gara për kryetarin e ri të Partisë Demokratike (PD) është hapur zyrtarisht. Kryetari aktual i PD-së, Lulzim Basha, ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, do të ketë përballë tre rivalë, Fatbardh Kadilli, Edith Harxhin, dhe Agron Shehaj, që të gjithë demokratë. Kryesia e PD-së ka diskualifikuar nga gara katër kandidatë të panjohur për anëtarësinë bashkë me Ibsen Elezin, kandidat nga

radhët e grupit për PD-në, i cili është penalizuar për shkak të qëndrimeve denigruese ndaj partisë. Lulzim Basha e ka marrë besimin e kryesisë drejt rrugëtimit për një mandat të tretë në krye të PD-së, por për ta shmangur konfliktin e interesit ai nuk është bërë pjesë e mbledhjes. Gara në selinë "blu" është bërë interesante me kandidimin e deputetit Agron Shehaj, i cili është bërë pjesë e listave të

PD-së me propozim të Bashës në vitin 2017. Përballje publike do të mungojnë mes kandidatëve edhe në këto zgjedhje. Fushata e 4 kandidatëve do të zgjasë 3 javë dhe do të jetë e ndarë, por zyra e shtypit e selisë blu ngarkohet për pasqyrimin e aktiviteteve në media. Zgjedhjet për kryetar të PD-së mbahen pas humbjes së zgjedhjeve të 25 prillit, ku fituese ka dalë Partia Socialiste (PS).



Shkupi dhe Sofja shënojnë festën e njëjtë të alfabetit

SHKUP/SOFJE, 24 MAJ - Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria të hënën kanë shënuar ditën e vëllezërve Kiri dhe Metodi, dy shenjtorë ortodoksë, themelues të alfabetit sllavë, që me disa modifikime përdoren në të dyja shtetet.

Shënimi i kësaj ngjarjeje, që për të dyja vendet ka rëndësi të madhe historike, ka shërbyer si pretekst që drejtuesit e dy shteteve t'i përsërisin qëndrimet lidhur me kontestin sa i takon gjuhës dhe identitetit maqedonas që ka bllokuar hapjen e bisedimeve të Maqedonisë së Veriut me BE-në.

Bullgaria ka pranuar

identitetin e ri maqedonas dhe gjuhën maqedonase të krijuara, siç kanë thënë, pas vitit 1945, ndërsa para kësaj periudhe Sofja pretendon se ato kanë pasur rrënjë bullgare. "Rruga e Maqedonisë së Veriut drejt BE-së kalon përmes Sofjes. Ne duhet të ulemi njëri me tjetrin dhe sinjerisht të bisedojmë për zgjidhjen e problemeve dypalëshe", ka deklaruar presidenti bullgar Rumen Radev, vendi i të cilit në nëntor të vitit të kaluar përdori veton për ta bllokuar hapjen e bisedimeve të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE. Presidenti bullgar ka thënë se kontesti me Shkupin ka zgjuar interes të madh mes vendeve



të BE-së, por pa përmendur fjalën presion. "Unë nuk do ta them fjalën presion por, të mos harrojmë, Bullgaria është anëtare e Bashkimit Evropian. Ne do t'u drejtohem anëtarëve të tjerë të BE-së për solidaritet. Gjëja më e rëndësishme është të mos lejojmë që probleme të reja të futen në Union", ka thënë presidenti bullgar Rumen Radev, i cili më 26 dhe 27 maj, së bashku me

presidentin maqedonas, do të udhëtojnë në Romë të Italisë për të marrë pjesë në një manifestim për nder të kësaj dite.

Ndërsa kryeministri maqedonas Zoran Zaev ka thënë se beson se fryma evropiane e këtij manifestimi do t'i japë shtysë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me Bullgarinë. "Unë besoj se fryma evropiane e presidentëve Radev dhe Pendarovski do të jetë një nxitje për të bërë një hap përpara për zbatimin e marrëveshjes për fqinjësi të mirë", ka thënë ai, shkruan "Rel".

Manifestime të përbashkëta janë mbajtur edhe në

ambasadat e dy vendeve në Beograd, Pragë, Varshavë dhe Kiev.

Më 21 maj ministri i Jashtëm portugez, Augusto Silva dhe komisionari për Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, kanë paraqitur në Shkup dhe Sofje një propozim të presidencës portugeze me BE-në për zgjidhjen e dallimeve midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut. Kryeministri Zoran Zaev ka thënë se propozimi paraqet një bazë të mirë për zgjidhje të kontestit pasi, sipas tij, nuk cenon çështjet që kanë të bëjnë me identitetin maqedonas, por pa dhënë detaje të tjera mbi këtë propozim.

Sekretari Blinken, vizitë zyrtare në Lindje të Mesme

UASHINGTON, 24 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka udhëtuar të hënën për vizitë zyrtare në Lindje të Mesme, për të diskutuar me zyrtarë izraelitë dhe palestinezë, pas arritjes së armëpushimit javën e kaluar, që mundësoi ndaljen e luftimeve 11-ditëshe në mes të Izraelit dhe militantëve palestinezë.

Ndërsa e parë e sekretarit Blinken do të jetë Izraeli dhe më pas ai do ta vizitojë Bregun Perëndimor, Jordaninë dhe Egjiptin. "Blinken do të takohet me udhëheqësit izraelitë në lidhje me angazhimin tonë të fuqishëm për sigurinë e

Izraelit", ka thënë presidenti amerikan Joe Biden përmes një deklaratë. Vizita e tij, sipas deklaratës, është pjesë e përpjekjeve të administratës amerikane për ta mbështetur popullin e palestinezë.

Në bisedime me zyrtarët e vendeve të rajonit, Blinken do të angazhohet për koordinim ndërkombëtar për të siguruar ndihma për Gazën.

Shtetet e Bashkuara synojnë ta ndihmojnë Gazën në atë mënyrë që mjetet të mos bien në dorë e Hamasit, grupit që udhëheq qytetin, por që konsiderohet terrorist nga Izraeli, ShBA-ja dhe vendet e tjera perëndimore.

Administrata e Bidenit ishte

kritikuar për reagimin e saj fillestar ndaj dhunës vdekjeprurëse. Kritika ka pasur edhe nga aleatët demokratë në Kongres, të cilët po bënin thirrje për një qëndrim më të ashpër ndaj Izraelit dhe përgjigjen e tij ndaj sulmeve me raketa nga Hamasi.

Në deklaratë, Bideni ka thënë se Uashingtoni ishte angazhuar për një "diplomaci të qetë dhe intensive" në mënyrë që të arrihet armëpushimi midis Izraelit dhe Hamasit.

Luftimet kanë filluar më 10 maj, pas disa javësh të rritjes së tensioneve izraelito-palentineze në Jerusalem.



Kulmi i tensioneve arriti kur përlëshjet filluan në një vend të shenjtë të nderuar nga myslimanët dhe hebrenjtë. Pastaj, Hamasi ka filluar të shkrepse raketa në drejtim të

Izraelit, duke shkaktuar sulme ajrore hakmarrëse të forcave izraelite. Dhuna atje ka lënë të vrrarë më shumë se 250 njerëz, shumica e tyre në Gaza.

Spanja fillon vaksinimin e 30 mijë të pastrehëve

Madrid, 24 maj - Spanja ka filluar të hënën një program të vaksinimit kundër Covid-19, për mijëra njerëz të pastrehë. Rreth 30 mijë të tillë nuk ishin të përfshirë më herët në procesin e imunizimit ndaj koronavirusit.

Administrata spanjolle ka hartuar një plan në të cilin

parashihet që të gjithë ta marrin vaksinën, edhe nëse jetojnë në rrugë, shkruan "Euronews".

Radhët ishin të gjata në qendrën San Isidro, ku është duke u realizuar vaksinimi.

Angela Alfonsa, një banore 67-vjeçare, ka thënë se është e lumtur dhe e lehtësuar që

është duke u imunizuar. "Tani që jam vaksinuar falënderoj zotin, jam lehtësuar shumë dhe falënderoj të gjithë mjekët dhe të gjithë ata që e kanë bërë të mundur", ka thënë ajo.

Të pastrehët kanë qenë një nga grupet më të ekspozuara ndaj virusit, me qasje të

kufizuar në maskat e fytyrës dhe higjienës së ulët. Vaksinimi i tyre ka paraqitur shumë sfida për autoritetet shëndetësore.

Drejtori i qendrës San Isidro e ka mirëpritur këtë veprim. "Ky është një përparim i shkëlqyeshëm sepse rreziku për të mos qenë në gjendje të

gjesh personin për një dozë të dytë është mjaft i madh në rastin e popullatës së pastrehë", ka thënë ai.

Spanja ka imunizuar 20 për qind të popullsisë së saj. Gati 90 për qind e njerëzve mbi 60 vjeç kanë marrë të paktën një dozë të vaksinës kundër Covidit.

Kurti: Të ndalet fushata e pasivizimit të adresave në Luginë të Preshevës

PRISHTINË, 24 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me zëvendëskryeministrin e parë, Besnik Bislimi, ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe zëvendësministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Ilir Kapiti, kanë pritur në takim kryetarin e Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi, Ragmi Mustafa, me bashkëpunëtorë.

Sipas njoftimit të qeverisë, në takim është biseduar për situatën aktuale në Luginën e Preshevës, në veçanti për çështjen e pasivizimit të adresave të banorëve shqiptarë të komunave me shumicë shqiptare, që posaçërisht është shtuar në Medvegjë. Me këtë rast, Kurti ka thënë se është duke e përcjellë me vëmendje

situatën me pasivizimin e adresave të shqiptarëve.

Ai ka theksuar se përderisa në të kaluarën Serbia tentonte t'i shpopullonte komunat me shumicë shqiptare me dhunë e tanke, tash po e bën në mënyrë administrative. "Kjo fushatë kundër banorëve shqiptarë të Luginës së Preshevës është e papranueshme dhe duhet të ndërpritet sa më parë", ka thënë Kurti.

Ndërsa Ragmi Mustafa e ka falënderuar Kurtin për pritjen në takim, në veçanti për fondet e ndara nga qeveria Kurti I gjatë krizës së pandemisë. Më tutje, ai ka paraqitur projekte të ndryshme që komunat me shumicë shqiptare synojnë t'i realizojnë.

Kurti dhe Mustafa janë pajtuar edhe për shtimin e bashkëpunimit për përmirësimin e pozitës së



shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc. Kujtojmë se në Serbi nuk ka numër të saktë të banorëve shqiptarë,

pasi shqiptarët patën bojkotuar regjistrimin e popullsisë të bërë më 2011. Çështjen e pasivizimit të

adresave e kishte ngritur më herët edhe deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi.

Ambasadori amerikan: ShBA-ja kërkon zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit, Bideni e di rëndësinë e Ballkanit



BEOGRAD, 24 MAJ - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Serbi, Anthony Godfrey, ka thënë të hënën se administrata e re amerikane ende dëshiron që gjithçka që është rënë dakord në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të zbatohet.

Godfrey ka thënë se ShBA-ja ende dëshiron që gjithçka që është rënë dakord në Uashington të zbatohet, duke rikujtuar se Amerika e ka mbështetur procesin që çon në një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe detyruese për normalizimin të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

"Administrata do të vazhdojë t'i trajtojë elementet e marrëveshjes së Uashingtonit si prioritet. Shtetet e Bashkuara bien dakord që disa nga çështjet zgjidhen më mirë

përmes dialogut të udhëhequr nga BE-ja dhe jemi të gatshëm ta mbështesim procesin sa më mirë që të mundet", ka thënë Godfrey.

Më tutje, ai ka thënë se presidenti Joe Biden e kupton shumë mirë rëndësinë e një Ballkani të qëndrueshëm dhe të prosperuar, si dhe një Evropë të bashkuar dhe të lirë. "Ne mbështesim plotësisht qëllimin strategjik të Serbisë për t'u bashkuar me BE-në dhe gjithçka që duhet të bëjë për të pasur sukses. Ndiham jonë përmes programeve në vetë Serbinë, si dhe mbështetja jonë e qartë politike për procesin e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, po e ndihmon Serbinë t'i zbatojë reformat e nevojshme dhe të ecim përpara në rrugën e saj evropiane", është shprehur ambasadori Godfrey.

Me leje të Ministrisë së Jashtme Petkoviqi viziton Kosovën

Prishtinë, 24 maj (ER) - Drejtori i të ashtuquajturës Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviqi, është duke e bërë një vizitë në Republikën e Kosovës, përkatësisht në Komunën e Leposaviqit, me leje të Ministrisë së Punëve të

Jashtme. Lajmin se Petkoviqi ka marrë leje nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e ka konfirmuar zëdhënësi i kësaj ministrie, Arben Rugova. "Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, në konsultim me institucionet e tjera

përgjegjëse, i ka dhënë leje zyrtarit serb, Petar Petkoviqi, për ta vizituar Republikën e Kosovës" është shprehur Rugova. Petkoviqi do të qëndrojë edhe sot (e martë) në Kosovë, ku do të takohet me qytetarë të Leposaviqit.





REPUBLIKA E KOSOVËS KA SHËNUAR 24 MAJIN - "DITËN E PRESIDENTIT"

'Dita e Presidentit', kërkohet unitet nga spektri politik

Në "Ditën e Presidentit", ish-presidentët Fatmir Sejdiu dhe Atifete Jahjaga, kanë kërkuar unifikim të spektrit politik për t'u përballur me sfidat me të cilat është duke u ballafaquar Kosova. Sipas tyre, vetëm të bashkuar dhe me vullnet të artikuluar Kosova mund t'i kalojë proceset e rëndësishme. Për nder të kësaj dite, presidentja Vjosa Osmani, së bashku me ish-presidentët Sejdiu, Pacolli e Jahjaga, kanë bërë homazhe te shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova, ku kanë vlerësuar lart rolin dhe kontributin e tij. Askush prej tyre nuk e ka përmendur ish-presidentin Hashim Thaçi i cili ndodhet në paraburgim në Hagë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 MAJ - Me rastin e shënimit të 24 Majit - "Ditës së Presidentit", presidentja e Republikës Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar ish-presidentët Fatmir Sejdiu, Behgjet Pacolli dhe Atifete Jahjaga, me të cilët ka bërë homazhe te shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova. Pas homazheve, ish-presidentët Fatmir Sejdiu dhe Atifete Jahjaga kanë bërë thirrje për bashkim të spektrit politik për t'i tejkuluar sfidat me të cilat përballet Republika e Kosovës. Ata kanë bërë me dije se vetëm të bashkuar dhe në partneritet me aleatët ndërkombëtarë Kosova mund t'ia dalë.

Ish-presidenti Sejdiu ka thënë se vështirësitë që paraqiten në rrugëtimin e Kosovës janë normale.

Ai ka vlerësuar se këto sfida mund të kalohen vetëm duke bashkëpunuar. "Kjo ditë simbolike shënon një kërkesë, një udhëzim, një mesazh për të treguar botërisht se që nga ajo

kohë Kosova ka ndërtuar institucionet e veta. Mund të ketë faza dhe periudha me vështirësi objektive, që është normale, sidomos kur një qenie e re del në sipërfaqe, por paralelisht me këtë them se mund t'ia dalim bashkë si njerëz me një vullnet të artikuluar mirë në kuptimin e zhvillimit të raporteve, në radhë të parë të asaj që ne e quajmë qeverisje e mirë, të një demokracie të mirëfilltë për vendin dhe një shpejtim i hapit tonë me mundësinë që kemi, natyrisht se në partneritet me aleatët që kemi", ka thënë Sejdiu.

Edhe ish-presidentja Atifete Jahjaga ka bërë me dije se uniteti i spektrit politik i vendit është i domosdoshëm për t'u përballur me procese dhe çështje të rëndësishme. "Me gëzon fakti se në këtë ditë ne po përvojim edhe një mesazh uniteti jo vetëm për ne si ish-presidentë, së bashku me presidenten aktuale. Por, për nevojën dhe domosdoshmërinë për të qenë unik, sidomos në proceset më të rëndësishme për vendin tonë, edhe në këtë

periudhë të pandemisë", ka deklaruar Jahjaga.

Presidentët vlerësojnë Rugovën, nuk e përmendin Thaçin

Pas kanë bërë homazhe te shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova, presidentja Osmani dhe ish-presidentët Sejdiu, Pacolli e Jahjaga kanë vlerësuar lart rolin dhe kontributin e ish-presidentit Ibrahim Rugova. Ata nuk kanë thënë asnjë fjalë për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili tani ndodhet në paraburgim në Hagë nën akuzat për, kinse, krime lufte nga Gjykata Speciale.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se ish-presidenti Rugova bashkoi popullin e Kosovës në kohët më të vështira. "Sot është 'Dita e Presidentit', e shpallur si e tillë nga presidenti historik dr. Ibrahim Rugova. Sot jam e nderuar që së bashku me ish-presidentët e filluam ditën duke e nderuar arkitektin e shtetit

tonë, njeriun i cili e bëri bashkë popullin e Kosovës, në mënyrë që të artikulohet qartë vullneti ynë për liri dhe pavarësi. 24 maji është ditë e rëndësishme, sepse përafërsisht rreth tri dekada qytetarët e Kosovës treguan se cili është vullneti i tyre. Treguan që askush nuk mund t'i ndalë në rrugën e tyre të drejtë për shtete të lira dhe pavarur", ka thënë Osmani. Ajo ka thënë se 24 maji nuk tregon vetëm historinë, por edhe të sotmen. "Njëkohësisht kjo ditë na kujton jo vetëm historinë, por edhe të sotmen dhe rëndësinë e një institucioni të tillë në përfaqësimin e unitetit të popullit, në sigurimin e funksionimit kushtetutës të institucioneve të vendit. Dhe natyrisht si presidente e vendit për mua është e rëndësishme që arkitektin e shtetit tonë ta kujtojmë ta përfaqësojmë së bashku me titullarët e këtij institucioni në faza të ndryshme të ndryshëm të

historisë sonë", ka thënë Osmani.

Edhe ish-presidenti Fatmir Sejdiu ka theksuar se 24 maji i 1992-s ishte një mesazh për të treguar botërisht se që nga ajo kohë Kosova ka ndërtuar institucionet e veta. "Unë vërtet mund të them se është një nga ngjarjet e rëndësishme ajo që është zhvilluar në vitin 1992, ishin zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale, ishte prova e parë, ishte referendum i përsëritur i Kosovës për lirinë dhe pavarësinë e saj dhe ishte një ego e madhe te qytetarët dhe pjesë ndërkombëtare e gjithë atyre që kanë dashur dhe kanë vrotuar Kosovën me simpati. Presidenti historik doktor Ibrahim Rugova është ikonë e pashembullt në gjithë epokat. Ne duhet ta kujtojmë me pietet peshën e vendimeve të tij dhe vizionit që ai e ka trasuar për ecjen tonë", ka





thënë Sejdiu.

Kontributin e ish-presidenti Rugova e ka vlerësuar lart edhe ish-presidentja Atifete Jahjaga. “24 maji është një datë e veçantë sepse ne po kujtojmë një figurë të rëndësishme të popullit të Kosovës, presidentin historik, i cili ishte presidenti i parë i zgjedhur në mënyrë demokratike, pikërisht më 24 maj 1992. Presidenti Rugova ishte ai i cili udhëhoqi popullin e Kosovës në periudhat më të rënda në të cilat ne po ballafaqoheshim si popull dhe shtet në rrezikun e shfarosjes edhe të kombit tonë që ballafaqoheshim në periudha të rënda”, ka deklaruar Jahjaga.

Kurse ish-presidenti Behgjet Pacolli ka vlerësuar Ibrahim Rugova për demokracinë e vendit. “Është një ditë përmes së cilës e kujtojmë presidentin historik dhe veprën e tij. Mos të harrojmë asnjëherë, se presidenti historik i Kosovës ka dhënë shumë për këtë vend dhe demokracinë, kështu që ia vlen gjithmonë ta kujtojmë me një manifestim simbolik”, ka thënë Pacolli.

Më pas, në një postim në profilin e vet në “Facebook”, Pacolli ka përmendur edhe ish-presidentin Hashim Thaçi. “Mos të harrojmë se presidenti i fundit i Kosovës, Hashim Thaçi, vazhdon të përballet me

Hoxhaj: Me mendje e zemër jemi te presidenti Thaçi

Në “Ditën e Presidentit”, ish-presidentin Hashim Thaçi, i cili ndodhet në paraburgim në Hagë, e kanë kujtuar ish-bashkëpartiaket e tij. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se me mendje dhe zemër është tek ish-presidenti Hashim Thaçi. “Në pritje të presidentit! Në ‘Ditën e

Presidentit’ me mendje e zemër jemi te Presidenti Hashim Thaçi. Ai që kishte vizion, guxim e veprimtari për Kosovën e mëvetësishme. Ai që udhëhoqi luftën për çlirim e rrugën drejt pavarësisë. Presidentin që po i mungon Kosovës më shumë se asnjëherë. Deri në ditën e madhe dhe të pashmangshme

të rikthimit në atdhe, ne do të jemi në pritje të presidentit”, ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Në këtë ditë ka shkruar edhe deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu. “‘Dita e Presidentit’. Historinë s’mund ta ndryshoj askush!”, ka shkruar Musliu në profilin e saj në “Facebook”.

drejtësinë padrejtësisht dhe i uroj kthim sa më të shpejtë në familje dhe vendin e tij. Kosovës i kemi borxh shumë, sepse është vendlindja jonë dhe meriton çdo të mirë. Po ashtu, nuk duhet t’i harrojmë asnjëherë ata që sakrifikuin çdo gjë për Kosovën”, ka shkruar Pacolli.

Nis punën biblioteka presidenciale ‘Dr. Ibrahim Rugova’

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në hapjen solemne të “Javës së Bibliotekës” në Kosovë dhe ka

folur për rëndësinë që kanë bibliotekat për qytetarët dhe shtetin. “Ndihej e nderuar që sot më jepet mundësia t’ju përshëndes nga kjo ndërtesë që si studente kam kaluar shumë kohë. Kjo javë vë në pah rolin thelbësor që bibliotekat kanë për promovimin e leximit. Të

dashur lexues dhe studiues, për ne bibliotekat përbëjnë qendra të ruajtjes së kujtesës tonë të përbashkët dhe të promovimit të vazhdueshëm të saj. Prandaj, ne kemi nevojë që ta bëjmë sa më të dukshëm rolin e bibliotekave dhe ta ruajmë funksionin e tyre si një ndër

shtyllat e forta të popullit të Kosovës”, ka deklaruar presidentja Osmani.

Më tutje, Osmani ka bërë me dije se pikërisht në “Ditën e Presidentit” do ta nisë punën edhe biblioteka presidenciale “Dr. Ibrahim Rugova”. “Kam nderin dhe entuziazmin e veçantë që pikërisht sot, në ditën e hapjes së ‘Javës së Bibliotekës’, por edhe në ditën kur me disa aktivitete po e shënojmë Ditën e Presidentit, e shpallur si e tillë nga presidenti historik dr. Ibrahim Rugova, t’ua kumtoj qytetarëve të Kosovës lajmin se nga sot nis punën edhe biblioteka presidenciale ‘Dr. Ibrahim Rugova’, e ndërtuar sipas modelit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e cila, po ashtu, është fryt i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve tona në radhë të parë dhe përkrahjes së pakursyer të miqve tanë nga ShBA-ja”, ka thënë Osmani.

Abdixhiku: Ibrahim Rugova, ati themeltar i shtetit të Kosovës

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka vizituar të hënën “Shtëpinë e Pavarësisë” për ta shënuar “Ditën e Presidentit”. Me këtë rast, ai ka thënë se ish-presidenti Ibrahim Rugova mbetet ati themeltar i shtetit të Kosovës. “Sot, me Albinën e me bashkëpunëtorë, vizituam ‘Shtëpinë e Pavarësisë’ për ta shënuar Ditën e Presidentit. Më 24 maj të vitit 1992 Kosova mbajti zgjedhjet e para shumëpartiake për Kuvendin dhe Presidentin e Republikës. Ibrahim Rugova u zgjodh presidenti i parë i Republikës së Kosovës dhe kështu nisi rrugëtimi ynë institucional për liri, pavarësi e demokraci. Pjesa



tjetër është histori e lavdishme që i mbijeton kohës. Ati themeltar i shtetit të Kosovës, dr. Rugova, i mbijeton kohës. Në ‘Shtëpinë e Pavarësisë’ njeriu gjen jo vetëm kujtesën e një elite intelektuale e një lëvizje popullore që përcaktoj të

ardhmen mbarë e mirë, por edhe motivin për të shërbyer me nder e përgjegjësi në këtë vend. Ky motiv është udhërrëfyes për secilin prej nesh sot e nesër”, ka shkruar Abdixhiku në llogarinë e vet në “Facebook”.



Kusari-Lila: Deputetët do të vaksinohen sipas planit të njëjtë për të gjithë qytetarët

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Republika e Kosovës nuk ka plan të veçantë për vaksinimin e deputetëve të Kuvendit. Kështu ka deklaruar, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të

Kosovës, ushtruesja e detyrës e shëfës së grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, e cila ka thënë se deputetët do të imunizohen sipas planit

nga institucionet shëndetësore. "Nuk e konsiderojmë se duhet të jenë përjashtim nga kategoritë e moshës së qytetarëve. Ata do të vaksinohen sipas planit të

vaksinimit sikur për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim", është shprehur Kusari-Lila. Kujtojmë se në Kosovë janë vaksinuar kundër Covidit mbi 57 mijë qytetarë.



Një i vdekur, 93 të shëruar dhe 14 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka vdekur një person nga Covidi dhe janë paraqitur 14 raste të reja. Po ashtu, IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar edhe 93 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 1 904 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 14 raste pozitive. Brenda 24 orëve është raportuar 1 rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rasti i vdekjes është nga komuna: Rahovec 1 rast (71 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 107 258 raste nga 593 728 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 2 240 raste të të

vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 93 pacientë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 101 467 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 551", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar rastet e reja me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 4 raste, Ferizaj 2 raste, Mitrovicë 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Fushë-Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik dhe Vushtrri. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ndërsa Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka bërë me dije se 211 pacientë me Covid janë duke i trajtuar në QKUK dhe spitalet e përgjithshme. ShSKUK-ja ka treguar se katër prej tyre janë në gjendje të rënduar, kurse 146 janë nën asistim të oksijenoterapisë.



Vdekja e foshnjës në Gjilan, 30 ditë arrest shtëpiak për gjinekologun



GJILAN, 24 MAJ (ER) - Gjykata Themelore në Gjilan ka caktuar masën e arrestit shtëpiak prej 30 ditësh për të pandehurin V. Th., gjinekologun për të cilin një grua ka njoftuar policinë se për shkak të tij ka ndërruar jetë foshnja e saj gjatë lindjes. "Ekziston dyshimi i bazuar, se më datë 21 maj 2021, i pandehuri V. TH., në Repartin e Gjinekologjisë në Spitalin Rajonal të Gjilanit, me rastin e lindjes së të dëmtuarës D. Ll.

nuk ka ndërmarrë veprimet me kohë për mjekim, pas lindjes, për një kohë të shkurtër është konstatuar se fëmija është pa shenja jete. Me këto veprime, i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale 'trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor', veprë e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës", ka njoftuar Gjykata Themelore në Gjilan. Sipas këtij njoftimi, gjyqtari i procedurës paraprake në

Departamentin e Krimeve të Rënda, ka vlerësuar se në rastin konkret përbushen të gjitha kushtet e nevojshme për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, ngaqë përveç dyshimit të bazuar në rastin konkret, plotësohet edhe kriteri ligjor i paraparë në nenin 183, paragrafi 1, nënparagrafi 2, lidhur me nenin 187, paragrafi 1, nënparagrafi 2, pika 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Tahiri kërkon nga Kurti sigurimin e vaksinave kundër Covidit

VUSHTRRI, 24 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka kritikuar qeverinë Kurti për sa i përket çështjes së vaksinave kundër Covid-19, duke theksuar se është vonuar shumë për sigurimin e tyre. Ai ka kërkuar nga qeveria Kurti që të angazhohen më shumë për sigurimin e dozave të mjaftueshme të vaksinave kundër Covidit dhe t'i nënshkruajnë kontratat me

kompanitë farmaceutike. "Unë mendoj që ne jemi vonuar shumë për sigurim të vaksinave. Interesimi i qytetarëve është shumë i madh dhe kërkesa e tyre për vaksinim është shumë e madhe. Si komunë po bëjmë të pamundurën me stafin tonë që ta kryejmë në kohë procesin e vaksinimit. Ju keni parë në Vushtrri një rregull të jashtëzakonshëm gjatë procesit të vaksinimit, por

mungesa e vaksinave ka bërë që të kemi fluks më të madh të njerëzve dhe të moshuarve nga frika se do të mbesin pa u vaksinuar dhe kjo po i shkakton tolloni. Prandaj ftesa ime si kryetar komune, në emër të të gjithë të moshuarve, është: ju lutemi siguroni sa më shumë vaksina. Më shpejt vaksinat, nënshkruajini kontratat. Asnjë prioritet më të madh në këtë vend", ka deklaruar Tahiri për "EO".



BE-ja dhe UNDP-ja ndihmojnë 7 500 familje të varfra

7 500 familje të varfra do të ndihmohen me artikuj ushqimorë nga Bashkimi Evropian (BE) dhe UNDP-ja. Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomash Szunyog, ka deklaruar se pandemia ka lënë pasojë sidomos te personat që po përballen me varfëri të skajshme

“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Bashkimi Evropian (BE) dhe UNDP-ja për gjashtë muaj do të ndihmojnë 7 500 familje që jetojnë në varfëri të skajshme me kuponë për ushqim, produkte higjienike dhe artikuj të tjerë të nevojshëm. Me këtë rast, shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomash Szunyog, ka deklaruar se pandemia ka lënë pasojë sidomos te personat që po përballen me varfëri të skajshme. Ai ka premtuar mbështetje për tejkalimin e vështirësive. “Kam kënaqësi të jem këtu sot që t’u ndihmojmë atyre personave më të cenueshëm që vuajnë nga pasojat e pandemisë. Pandemia ka rritur hendekun mes personave që kanë dhe atyre që nuk kanë. Përtej varfërisë personave me aftësi të kufizuara u është vështirësuar jeta. BE-ja është këtu për të ndihmuar e për të sjellë vaksina përveç tyre edhe ndihma humanitare”, është shprehur ai. Më tutje, ai ka treguar se si pjesë

e projektit është edhe angazhimi i 40 punëtorëve socialë të cilët do t’u dalin në ndihmë qendrave sociale në Kosovë. “Sot dorëzojmë një ndihmë ekonomike për familje në varfëri për 7 500 familje me kuponë mujor për ushqime dhe për produkte higjienike. Rezultati i dytë është grupi prej 40 personave që do të punojnë në qendrat për asistencë sociale. Kjo skemë shërben edhe për përgatitjen e punëtorëve socialë pas përfundimit të studimeve. Jam i sigurt që këto do të japin rezultat. Falënderoj UNDP-në e të tjerët. Thesoj nevojën e solidaritetit me këto kohë”, ka deklaruar Szunyog. Ndërsa Maria Suolko nga UNDP-ja ka deklaruar se pandemia ka vënë në pah mungesat në strukturat institucionale si dhe ka thelluar pabarazinë. “Edhe pse pandemia ka filluar me emergjencë shëndetësore, la pasojë të gjera edhe ekonomike. Mungesat në strukturat institucionale janë vënë në pah. Kemi parë rritje të



pabarazisë. Rreth 45 për qind e popullatës nuk ka qasje në të drejtën shëndetësore në botë. Kosova dhe populli i saj nuk janë kursyer nga efektet e pandemisë. Kriza ka goditur ata që kishin vështirësi për t’ia dalë mbanë. Kjo iniciativë do t’u ofrojë mbështetje atyre që jetojnë në varfëri. Kjo është në thelb përpjekje me vëmendje të veçantë të gratë dhe të vajzat, pra t’u ofrojmë ndihmë atyre që janë në gjendje më të cenueshme. Do të punojmë

ngushtë me kolegët nga OKB dhe Ministria e Financave dhe partnerët e tjerë. E falënderoj Zyrën e BE-së për besimin që ta kryej këtë punë UNDP”, ka thënë ajo. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe ministri i Financave, Hekuran Murati. Ai ka deklaruar se kjo ministri do ta vazhdojë përkushtimin për të tilla nisma. Murati ka thënë se rritja e çmimeve të produkteve gjatë pandemisë e ka rritur edhe më

shumë barrën e familjeve në nevojë. “E vlerësojmë këtë projekt për lehtësimin e barrës së familjeve në nevojë dhe përgatitjen e personave socialë. Pandemia ka ndikuar në rritjen çmimeve në artikujt ushqimorë që ka rritur edhe më shumë barrën e familjeve në nevojë. Përkushtimi ynë do të vazhdojë”, ka deklaruar Murati. Blerim Shabani nga Qendra Sociale në Prishtinë është një nga zyrtarët që ka pranuar kuponin për këto familje.

Kuvendi të enjten mban seancë



PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës është mbledhur të hënën, nën drejtimin e kryeparlamentarit Glauk Konjufca, për ta përcaktuar agjendën e punës së Kuvendit për këtë javë. Kryesia, në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, ka vendosur që seanca e radhës e Kuvendit të mbahet të enjten, më 27 maj

2021, në orën 10:00.

Në seancën e të enjtes, pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi do ta shqyrtojë Raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2020, ndërsa më pas do të formojë dy komisione ad-hoc: Komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve për tre anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe atë për përzgjedhjen e

kandidatëve për tre anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media. Më pas, deputetët do të debatojnë në lidhje me organizimin e arsimit në të gjitha nivelet në situatën e pandemisë Covid-19, ndërsa në fund do ta shqyrtojnë kërkesën e Komisionit për Shëndetësi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 08-V-006 për formimin e komisioneve parlamentare.

Përkujtohen dëshmorët e batalionit ‘Shkelzen Haradinaj’

DEÇAN, 24 MAJ (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe ish-komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe pranë varrezave të dëshmorëve të Batalionit Gardist “Shkelzen Haradinaj”. Në 22-vjetorin e rënies së tyre, Haradinaj ka thënë se këta dëshmorë ishin djemtë e zgjedhur të kombit

shqiptar. “Ata ishin djemtë e zgjedhur të këtij kombi. Ata u bënë mburojë e vëllezërve të tyre prej arme, të plagosur në betejë. Ata ishin Batalioni Gardist ‘Shkelzen Haradinaj’. Sot dhe përgjithmonë kujtojmë dhe nderojmë luftën heroike dhe sakrificën, flijimin dhe vetëmohimin e tyre”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



Deputetja Balje merr mbështetje për njohjen reciproke të sigurimeve me Bosnjën

Deputetja e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e komunitetit boshnjak, Duda Balje, është takuar me drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Sami Mazreku. Me këtë rast, Mazreku i ka ofruar deputetes Balje mbështetje për njohjen reciproke të sigurimeve me Bosnjë Hercegovinën

“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 MAJ - Deputetja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Duda Balje, të hënën është takuar me drejtorin ekzekutiv të Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, nga i cili ka marrë mbështetje

për heqjen e aplikimit të sigurimit kufitar me Bosnjë Hercegovinën, përmes njohjes reciproke të certifikatave të sigurimit të vlefshme për vendet respektive.

Deputetja Balja ka kërkuar që Byroja Kosovare e Sigurimit në bazë të kompetencave

ligjore që ka, ta shikojë mundësinë që Kosova dhe Bosnja ta heqin aplikimin e sigurimit kufitar, duke zbatuar modalitetet e njohura nga sistemi i Kartonit të Gjellbër. “Ne sot takuam drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimit. Nga i njëjti kërkuam që të hiqet kjo pengesë për

qarkullimin e qytetarëve të të dy vendeve. Mazreku na dha mbështetje për këtë iniciativë për të cilën vlerësoj që do të mirëpritet nga dy vendet. Kjo nisimë do të ishte pozitive, pasi që edhe qeveria ka marrë vendim që të udhëtohet me letërnjoftime”, është shprehur ajo.

Kurse drejtori ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, ka falënderuar deputeten Balje dhe zëvendësministrin e MZHR-së, Almir Veliji, për vizitën, duke shprehur gatishmërinë për të

hapur një dritare të re të bashkëpunimit me Bosnjë Hercegovinën. “Ne mirëpritëm sot në vizitë deputeten Balje, përkrahëm iniciativën e saj që ne si byro ta shikojmë mundësinë ta heqim sigurimin kufitar me Bosnjën duke mundësuar lëvizjen përmes njohjes reciproke të certifikatave të sigurimit të të dy vendeve. Tani për tani, një proces të tillë të njohjes reciproke të sigurimeve për territoret respektive jemi duke e finalizuar me Byron e Malit të Zi”, ka deklaruar Mazreku.



Dërgesat e diasporës në Shqipëri arritën në 1.5 miliard dollarë, më të ulëtat në rajon gjatë vitit 2020

PRISHTINË, 24 MAJ - Industria e dërgesave të parave ka qenë pjesë e përshejtit të digjitalizimit, që është e vëzhguar në shumë dimensione të jetës gjatë krizës së pandemisë Covid-19. Sipas një raporti të ri të Bankës Botërore, duke filluar nga qershori i 2020-s, flukset e remitancave përmes kanaleve digjitale janë rritur, veçanërisht për emigrantët me qasje në llogaritë bankare dhe kartat e kreditit. Raporti tregon se Shqipëria renditet në dhjetëshen e përfituesve më të mëdhenj të remitancave në Evropë dhe Azinë Qendrore, ndonëse në shifra më të ulëta sesa rajoni. Sipas këtij raporti, përfituesi kryesor në Evropë i remitancave ka qenë Ukraina, ndjekur nga Rusia dhe Uzbekistani. Shqipëria, e fundit me 1.5 miliard dollarë në 2020, ndërsa në raport me Prodhimin



e Brendshëm Bruto ishte 9.7 për qind.

Raporti shpjegon se, duke u përballur me një mungesë të madhe të fuqisë punëtore në sektorë kyçë (të tillë si bujqësia, ndërtimi, mikpritja dhe shërbimet e kujdesit) mes krizës Covid-19, qeveria gjermane vendosi ta zgjasë programin e rregullimit të Ballkanit Perëndimor nën të cilin

shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Mali të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë gëzojnë qasje të privilegjuar në tregun gjerman të punës. “Përveç kësaj, shtetasit e Ballkanit Perëndimor përfituan më së shumti nga Akti i ri i Imigracionit të Punëtorëve të Kualifikuar. Nga 30 200 viza me aftësi të larta të lëshuara në vitin 2020, gjithsej 2 024 u janë dhënë

shtetasve serbë, 1 159 boshnjakëve dhe 778 shtetasve shqiptarë”, thuhet në raport.

Sa i përket digjitalizimit të sektorit, raporti tregon se shumë operatorë kryesorë të transferimit të parave raportuan rritje me dy shifra në shërbimet e tyre digjitale, në kontrast të fortë me rënieën e shërbimeve të tyre të dërgesave të parave. Kalimi nga para kesh në kanale digjitale duket se ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2020.

Të dhënat e fundit treguan se remitancat ndërkuftare u rritën me 65 për qind në vitin 2020, nga 7.7 miliardë dollarë në 2019 në 12 miliardë dollarë në vitin 2020, duke arritur mbi 1 miliard dollarë në transaksionet e dërguara dhe të marra çdo muaj. Besohet se ka pasur edhe një zhvendosje të gjerë në flukset nga kanalet informale në ato zyrtare në vitin 2020.

Meqenëse dërgesat digjitale

regjistrohen më mirë sesa dërgesat e parave kesh, veçanërisht ato të kryera me dorë ose të dërguara përmes kanaleve të tjera informale, të dhënat zyrtare ka të ngjarë të regjistrojnë më shumë remitanca edhe nëse madhësia e vërtetë e dërgesave të parave mund të bjerë. Ky vëzhgim është në përputhje me faktin se një numër i madh i familjeve të anketuara në TM2 raportuan se morën remitanca më të ulëta që nga fillimi i Covid-19 në Meksikë me 35 për qind dhe Republikën Dominikane me 54 për qind edhe kur bankat qendrore regjistruan flukse hyrëse më të larta. Madhësia e vërtetë e dërgesave të parave, që përfshin flukse zyrtare dhe informale, besohet të jetë më e madhe se të dhënat e raportuara zyrtarisht, megjithëse shkalla e ndikimit të Covid-19 në flukset informale është e paqartë. /Monitor/

Thellohet deficiti tregtar në Kosovë

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 100.5 për qind në muajin prill 2021 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020, gjegjësisht në vlerë prej 323.4 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 161.2 milionë eurosh në vitin 2020. Sipas ASK-së, eksporti mbulon importin me 15.9 për qind



Kosovës me vendet e CEFTA-së arritën në 23.5 milionë euro, ose 38.5 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 44.8-përqindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (15.6 për qind), Maqedonia e Veriut (11.0 për qind), Serbia (6.3 për qind), dhe Mali i Zi (3.4 për qind).

“Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin prill 2021 arritën në 76.7 milionë euro, ose 20.0 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 103.8-përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (6.8 për qind), Shqipëria (5.9 për qind), dhe Maqedonia e Veriut (5.4 për qind).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 18.6 milionë euro, ose 30.5 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: ShBA-ja (15.9 për qind) dhe Zvicra (7.6 për qind), ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 133.0 milionë euro, ose 34.6 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (13 për qind) dhe Kina (7.7 për qind)”, është thënë në raportin e ASK-së.

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin prill 2021. Sipas ASK-së, të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 100.5 për qind në muajin prill 2021, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020, gjegjësisht në vlerë prej 323.4 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 161.2 milionë eurosh në vitin 2020. Eksporti mbulon importin me 15.9 për qind. “Eksporti i mallrave në muajin prill 2021 kishte vlerën 61.1 milionë euro, ndërsa importi 384.5 milionë euro, që është një rritje prej 86.9-përqindësh për

eksport dhe 98.2 për qind për import, duke bërë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit, 36 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 18.1 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 11 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 7.6 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 5 për qind e përbëjnë produktet minerale; 5 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 4.8 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij etj”, është thënë në raportin e ASK-së.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 13.8 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike

dhe elektrike; 13.2 për qind e përbëjnë produktet minerale; 11.3 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.9 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9.1 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 8.8 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 7.1 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj.

“Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 18.9 milionë euro, ose rreth 31 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 77.8-përqindësh.

Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Italia (9.1 për qind), Gjermania (7.8 për qind), Bullgaria (2.6 për qind) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 174.7 milionë euro, ose 45.4 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 85.3-përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (14.7 për qind), Italia (5.4 për qind), Sllovenia (4.5 për qind), Greqia (3.3 për qind) etj.”, thuhet në raportin e ASK-së, duke shtuar se në muajin prill 2021 eksportet e

Sot protestojnë gastronomët



PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Shoqata e Gastronomëve e Kosovës ka bërë me dije se do të protestojë sot (e martë), duke filluar në orën 18:00. Petrit Kllokoqi nga kjo shoqatë

ka thënë se përmes kësaj proteste dëshirojnë t’ua hapin “sytë” institucioneve sa i përket situatës së këtij sektori. “S’kemi pretendime të ndërrojmë qeveri, po t’ua hapim ‘sytë’ për

kërkesat tona. Janë 450 ditë që ka biznese të mbyllura pa kompensime. Nuk kanë efekt më masat. Thërrasim lirim të masave meqë jemi para ardhjes së diasporës e jo kur të vijë

koha për fushatë”, ka shkruar Kllokoqi në llogarinë e vet në “Facebook”.

Ai ka thënë se nuk dëshirojnë që si sektor i gastronomisë ta humbin edhe një verë si pasojë

e masave kundër Covidit. “Nuk po dalim të protestojmë që t’i dëmtojmë pronat e shtetit, por që ta shfrytëzojmë të drejtën tonë kushtetuese”, ka shkruar Kllokoqi.

OKMF-ja në Suharekë ofron shërbime të pediatriisë

SUHAREKË, 24 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se tani e tutje në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në këtë komunë do të ofrohen shërbime të pediatriisë. Ai ka thënë se ky shërbim ka

munguar që më shumë se 10 vjet. “Sot prindërit e vogëlushes Roana Kadriaj nga Krushica e realizuan vizitën e parë për vajzën e tyre në Shërbimin e Pediatriisë në QKMF - Suharekë. Dr. Safete Shurdhaj, specialiste e pediatriisë, do të ofrojë

shërbime të pediatriisë në QKMF-Suharekë, një shërbim që ka munguar më shumë se 10 vjet për fëmijët e Komunës së Suharekës. Po punohet vazhdimisht që të kemi shërbime sa më të mira për qytetarët tanë”, është shprehur Muharremaj.



Vazhdon pastrimi i Gjakovës

GJAKOVË, 24 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se në kuadër të garës për një Gjakovë të pastër, ka vazhduar tërheqja e drunjve që janë krasitur gjatë javës në disa pjesë të kësaj komune. Në këtë drejtim ai ka thënë se janë duke promovuar që të kenë një operacion të disafishtë, përpos të pastrimit të degëve të drunjve.

“Në kuadër të garës për Gjakovë të pastër, sot po vazhdon tërheqja e drunjve që janë krasitur gjatë javës. Po provojmë të kemi një operacion të disafishtë, përpos që po pastrojmë degët e drunjve, ato do të dhurohen për ngrohtoren e qytetit duke pasur parasysh që ngrohtorja tani punon me biomasë. Jam

falënderues ndaj secilit që sot i është përgjigjur thirrjes publike për të qenë pjesë e këtij aksioni pastrimi që në të njëjtën kohë është një mundësi më shumë që hapësirat e pastruara të kthehen në destinim rekreativ për secilin qytetar”, ka thënë Gjini, duke shtuar se është e dhimbshme të shohësh që disa njerëz punojnë e disa të tjerë në mënyrën më të pandërgjegjshme hedhin mbeturina.

“Nga sot edhe zyrtarisht fillon kampanja për shqiptimin e gjobave mandatore, gjë e cila mundëson dënimin e të gjithë atyre që hedhin mbeturina. Duhet të fillojmë ta trajtojmë këtë vend më mirë, por vetëm nuk mund ta bëjmë!”, ka thënë Gjini.



Fillon fushata e dezinfektimit selektiv kundër rriqrave në Malishevë

Malishevë, 24 maj (ER) - Në kuadër të zbatimit të programit për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike kongo (EHKK), të hënën në territorin e Komunës së Malishevës ka filluar fushata e dezinfektimit kundër rriqrave, të cilat janë bartës të virusit vdekjeprurës të etheve hemorragjike kongo. Dezinfektimi kundër rriqrave është një nga masat parandaluese të përhapjes së EHKK. Kjo fushatë ka filluar në fshatin Drenoc, ndërsa zbatimin e kësaj fushate të dezinfektimit e ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës,



Hajdin Berisha dhe drejtori komunal për emergjenca, Hafir Rexha.

Fushatën e dezinfektimit, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, e

ka vlerësuar “si një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm në kuadër të

zbatimit të masave parandaluese, pasi rriqra është bartëse e virusit dhe dezinfektimi i zonave ku ka më shumë raste të thumbimeve nga rriqrat, është i domosdoshëm”.

Ai ka kërkuar nga ana e institucioneve përgjegjëse, përkatësisht nga AUV, që të marrin masa për zbatimin e masës më efektive në luftimin dhe parandalimin e EHKK, atë të repelimit të kafshëve, pasi kjo masë ndihmon në ndërprerjen e ciklit të rriqrave dhe zvogëlon mundësinë e zhvillimit të virusit të rriqrave, e rrjedhimisht edhe bartjes së virusit nga rriqra te njeriu.

Gjilani pranon 133 pako ushqimore dhe higjienike nga zyra e OKB-së

GJILAN, 24 MAJ (ER) - Komuna e Gjilanit ka pranuar të hënën një donacion prej 133 pakove ushqimore dhe higjienike nga Zyra e OKB-së në Kosovë. Me këtë rast, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka falënderuar Zyrën e OKB-së për këtë donacion dhe për mbështetjen e vazhdueshme për qytetarët e Gjilanit. “E

falënderoj misionin e OKB-së në Kosovë për mbështetjen në kohë pandemie me pako ushqimore dhe pako higjienike për qytetarët e Gjilanit që janë në listën e gjendjes sociale, për një mirëqenie më të mirë. Ne kemi qenë përfitues edhe të disa programeve të tjera nga Tahir Zanin, përfaqësues

special dhe Freemani”, ka thënë Haziri.

Ndërsa Barrie Freeman, zëvendëshefe e Zyrës së OKB-së në Kosovë, ka thënë se ndihet mirë që ka dorëzuar këtë donacion, i cili është mbështetje për njerëzit në nevojë në Komunën e Gjilanit për ta përballuar situatën me pandeminë.



REAGIM I KMDLNJ-SË

Tensionim i panevojshëm në Kamenicë, komuna ka përgjegjësi për arsim!



Në disa fshatra të Komunës së Kamenicës kohë më parë ka filluar një reformë në fushën e arsimit që ka nënkuptuar se disa shkolla do të mbyllen dhe se nxënësit do të zhvendosen në shkollat e fshatrave që nuk janë larg nga vendbanimi e që shpenzimet për transport deri te shkolla e re do të mbulohehin nga buxheti i Komunës së Kamenicës. Që në fillim, një numër i prindërve por edhe i personelit arsimorë ka kundërshtuar këtë zhvendosje, fillimisht vetëm verbalisht e më vonë edhe me organizimin e protestave. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) nga fillimi ka përkrahur reformat e nisura në Komunën e Kamenicës duke konsideruar se kjo është përgjegjësi ekskluzive e komunës përkatësisht Drejtorisë Komunale për Arsim (DKA) dhe kryetarit të komunës dhe ka kundërshtuar çdo ndërhyrje nga jashtë të cilët nuk kishin asnjë interes në Komunën e Kamenicës përveç ndërhyrjeve

për interes politik.

E kemi një situatë absurde në një shtet ku ligjet vlejnë për të gjithë qytetarët apo, së paku ashtu shkruan në dokumentet zyrtare; në kohën kur në komunat me shumicë serbe, komuna e organizon sistemin arsimorë nga niveli parashkollorë e deri te ai universitar dhe ku mësohet me planprogramet e Serbisë, në Komunën e Kamenicës kjo e drejtë iu mohohet DKA-së dhe kryetarit të komunës, Qëndron Kastratit, ndonëse me asgjë nuk e kanë shkelur ligjin dhe nuk ka punuar kundër interesave të vendit, të komunës dhe të vet nxënësve.

E drejta për një arsim cilësorë është e drejtë e njeriut dhe të gjithë ata që janë kundër janë shkelës të të drejtave të njeriut. Mësimdhënia dhe mësimnxënia në një mjedis jo të përshtatshëm social, në kushte jo të mira fizike, klasë me 2-3 nxënës, klasë ku mbajnë mësim nxënës të moshave të ndryshme, situatë kur një mësues apo arsimtar jep shumë lëndë mësimore nuk siguron cilësi për një arsim por,

madje është shumë dekurajuese për një nxënës dhe një mësimdhënës dhe ua mohon mundësinë për një të ardhme më të mirë sikur që i lë në pozitë të pabarabartë këta nxënës gjatë konkurrimit për nivel më të lartë të arsimit.

Reformat e filluara të arsimit nga DKA-ja e Kamenicës dhe kryetari Qëndron Kastrati kanë për qëllim të krijojnë kushte më të mira për nxënësit dhe arsimtarët sikur që e racionalizon buxhetin e komunës për arsim. Kjo reformë krijon një mjedis social për të gjithë nxënësit duke krijuar klasa të kompletuara dhe duke e afirmuar konkurrencën e dijes midis nxënësve. Gjithashtu, kjo reformë nuk ka për qëllim të largojë nga puna mësimdhënësit prandaj kjo frikë është e pambështetur.

Zhvillimet e fundit sidomos në fshatin Shipashnicë e Poshtme i qesin një hije të keqe të gjithëve, nxënësve, arsimtarëve,

prindërve, zyrtarëve të Komunës së Kamenicës dhe Policisë së Kosovës e cila ka intervenuar në zbatim të Ligjit. Në Kosovë nuk është vetëm Kamenica që ka filluar reforma në arsim mirëpo nuk ka pasur reagime sikur në Kamenicë. Duket se është duke u zhvilluar një fushatë kundër kryetarit Kastrati e që ka një prapavijë politike, ndryshe si mund të kuptohet ndërhyrja në kompetencat që ekskluzivisht i takojnë komunës dhe kryetarit të saj.

KMDLNJ-ja ka përkrahur fillimin e reformave të arsimit në Komunën e Kamenicës, i përkrahë edhe sot, deri në momentin kur nuk e dëmtojnë interesin e nxënësve, angazhohet për krijim të kushteve për një arsim cilësorë, i përkrah kompetencat e DKA-së dhe kryetarit të komunës sikur që kërkon përgjegjësi nëse punojnë jashtë kompetencave të lejuara me ligjet në fuqi. Kërkesat për

shkarkim të kryetarit Kastrati nga deputetë që nuk e bëjnë punën si duhet në vendin e tyre të punës, KMDLNJ-ja i konsideron si bashkëngjitje dhe fushatë kundër DKA-së në Kamenicë dhe kryetarit Kastrati dhe përpjekje për linçim, tash nga një pozitë më e lartë dhe me armë më të rënda verbale. Nga kjo situatë e tensionuar e që, sipas KMDLNJ-së është krijuar pa asnjë nevojë, zgjidhja është shumë e lehtë, respektimi i ligjit dhe kompetencave që iu jep ligji për të gjithë, pa bërë asnjë dallim dhe diskriminim. Edhe ashtu, për shkak të mungesës të një reforme të mirëfilltë në fushën e arsimit, e kemi një gjendje siç e kemi, pandemia e shkaktuar nga Covid-19 e ka thelluar edhe më shumë këtë agoni sikur që edhe pengimi i reformave do t'i vë gozhdën e fundit arkivolit në të cilin është shtrirë arsimi kosovar, në të gjitha nivelet!



Komuna e Mitrovicës subvencionon me sera 50 fermerë

MITROVICË, 24 MAJ (ER) - Në kuadër të planit të punës të Drejtorisë për Bujqësi është realizuar projekti i radhës për subvencionim të fermerëve në fushën e serave, me ç'rast kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me drejtorin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku, kanë ndarë të hënën sera për 50 fermerë të kësaj komune.

Kryetari Bahtiri ka përshëndetur fermerët përfitues të projektit, duke iu dëshiruar suksese në punën e tyre edhe në të ardhmen. "Komuna, në bazë të mundësive dhe kapaciteteve buxhetore, po përpiqet ta mbështesë zhvillimin e bujqësisë, duke iu ofruar

subvencione të ndryshme, kësaj radhe me sera në disa lokalitete të ndryshme", ka thënë kryetari Bahtiri. Ai ka kërkuar nga qytetarët e pranishëm që të jenë pjesë e dëgjimeve publike buxhetore të cilat do të organizohen shumë shpejt nga Drejtoria e Financave, ku kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve do të merren parasysh.

Ndërsa fermerët përfitues kanë shprehur mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që po u jep komuna. Ata kanë thënë se do të punojnë maksimalisht për përkujdesje dhe mirëmbajtje të serave, me qëllim të arsyetimit të mbështetjes dhe prodhimit sa më të mirë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Islami largohet nga Feronikeli, arrin marrëveshje me Dritën

Futbollisti Përparim Islami të hënën ka ndarë rrugët me Feronikelin dhe menjëherë ka gjetur skuadrën e re. Bëhet fjalë për Dritën e Gjilanit. Gazeta e ka kontaktuar Islamin, i cili e ka pranuar se ka kontakte me skuadrën gjilanase, por ka mohuar të ketë arritur marrëveshje



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 MAJ - Mbrojtësi Përparim Islami të hënën ka konfirmuar se është larguar zyrtarisht nga skuadra e Feronikelit. "Rruki" me sukses të plotë mbrojti ngjyrat e Feronikelit përgjatë tri viteve, duke arritur të fitojë të gjithë trofetë e mundshëm në futbollin e Kosovës, po ashtu ai ishte pjesëmarrës edhe në garat evropiane. "Nuk jam më pjesë e FC Feronikelit. Falënderoj drejtuesit e klubit, konkretisht presidentin Naser Ramaj për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin fantastik. Falënderoj të gjithë trajnerët me të cilët kam punuar, po ashtu

edhe shokët e skuadrës që kemi qenë së bashku gjatë këtyre tre vjetëve, ku arritëm t'i fitojmë të gjithat kupat e mundshme në Kosovë. Një falënderim kam edhe për të gjithë qytetarët e Drenasit dhe kryetarin Ramiz Lladrovci, të cilët gjithmonë na kanë qëndruar afër gjatë këtyre viteve", ka thënë Islami. Ndërsa tifozët e skuadrës së Feronikelit, "Tigrat e Zi", e kanë falënderuar Islamin për kontributin e madh që ka dhënë për këtë klub. "Faleminderit Përparim Islami-'Rruki' që kontribuove për klubin e qytetit tonë. 'Tigrat e Zi' do të respektojnë gjithmonë, andaj qyteti ynë është shtëpia jote. Ne si tifozët të urojmë shëndet e suksese të mëtutjeshme në

karrierën tënde", thuhet në reagimin e tifozëve "Tigrat e Zi". Mbrojtësi që ka bërë karrierë në skuadrën e Prishtinës, Trepçës '89, Hysit dhe Hajvalisë, karrierën futbollistike do ta vazhdojë në skuadrën e Dritës nga Gjilani. Gazeta "Epoka e re" ka mësuar se marrëveshja është arritur derisa kanë mbetur vetëm disa hollësi të vogla për zyrtarizimin e saj. Gazeta e ka kontaktuar edhe mbrojtësin e krahut të djathtë, i cili ka bërë me dije se ka disa oferta, por që ende nuk ka arritur marrëveshje me ndonjë klub. "Oferta kam nga disa klube, por ende nuk kam arritur marrëveshje me asnjërën prej tyre. Shumë shpejt do të vendos se në cilin klub do ta vazhdoj karrierën time", ka deklaruar Islami.

SHKURT

Hila dhe Çyrbja largohen nga Gjilani

SC Gjilani ka filluar të mendojë për sezonin e ardhshëm. Që tani ka shpallur kandidaturën për titullin kampion. Skuadra "kuqebardh" me marrëveshje të dyanshme i ka dhënë fund bashkëpunimit me mesfushorin Ardit Hila dhe sulmuesin anësor Arbër Çyrbja. Hila ishte transferuar te Gjilani nga skuadra e Prishtinës, kurse Çyrbja kishte zënkuar në Gjilani nga Teuta e Durrësit. Hila, gjithashtu, e ka falënderuar klubin përmes një 'story' të publikuar në rrjetet sociale me mesazhin: "Faleminderit SC Gjilani!". Në ditët në vijim priten edhe largime të tjera nga kampi gjilanas.

Daku: Ndihe mirë që emri im u shënuar në histori

Mirlind Daku e ka mbyllur edicionin 2020/2021 si golashënuesi më i spikatur i Superligës së Kosovës. Sulmuesi gjilanas ka realizuar plot 31 gola në një edicion të vetëm. Daku është shprehur i lumtur me arritjen e tij duke shkruar historinë e futbollit të Kosovës pasi askush më herët nuk e ka arritur këtë shifër. "Është ndjenjë e jashtëzakonshme pasi kam pasur shumë sakrificat ndër vite për të arritur në këtë sukses. Ndihe mirë që emri im është shkruar në historinë e Kosovës", ka thënë Daku në emisionin "Ekipi A" në ATV. Kujtojmë se Mirlind Daku e ka thyer rekordin e Otto Johnit i cili kishte realizuar 27 gola brenda një sezoni në edicionin 2016/2017.

Khaka në formacionin e vitit në Premierë Ligë

"Football Observatory" e ka zgjedhur mesfushorin shqiptar të Arsenalit, Granit Khaka, në formacionin e edicionit 2020/21 në Premierë Ligë. Khaka është paraqitur në 31 ndeshje për skuadrën e Arsenalit në këtë edicion. Formacioni (4-2-3-1): Ederson, Cancelo, Lindelof, Dias, Robertson, Rodri, Khaka, Fernandes, Mount, Sterling, Kane.

Ramadani konfirmon largimin nga Velje

Pas katër sezonesh me fanellën e Veljes në kampionatin danez të futbollit, mesfushori i kombëtares shqiptare, Ylber Ramadani, ka vendosur të largohet, për të provuar një përvojë të re. Lajmin e ka dhënë vetë futbollisti nëpërmjet një postimi në "Instagram", ku zbulon se i ka përfunduar kontrata me Veljen dhe se do të kërkojë për një tjetër përvojë, teksa nuk ka ngurruar t'i falënderojë edhe tifozët e skuadrës. "Fansa të dashur, ka ardhur koha të largohem nga Velje. Dua t'ju falënderoj të gjithëve që qëndruan me mua këto katër vjet, në ditë të mira dhe të këqija, në ulje dhe në ngritje, ne qëndruam të fortë. Ju u bëtë pjesë e familjes time dhe keni një vend special në zemrën time. Jam shumë krenar që isha pjesë e skuadrës së Veljes dhe ne shkruam historinë së bashku. Falënderimi special për shokët e skuadrës, trajnerët e mi, presidentin dhe stafin. Ju uroj shëndet dhe gjithë të mira, jeni të bekuar, shumë dashuri për ju të gjithë", ka shkruar Ramadani.

Të premtën ndeshja e barazhit Trepça '89 - Dukagjini

Prishtinë, 24 maj - Ndeshja e barazhit ndërmjet Trepçës '89 dhe Dukagjinit do të zhvillohet të premtën (më 28 maj) në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet në orën 16:00. Kjo ndeshje do të përcaktojë se cila prej këtyre dy skuadrave do të

jetë pjesë e Superligës në edicionin e ardhshëm. Skuadra e Dukagjinit e mbylli edicionin në pozitën e dytë në Grupin A të Ligës së Parë, kurse më pas e fitoi ndeshjen e barazhit të kësaj lige ndaj Flamurtarit, duke e fituar të drejtën

që rikthimin në elitë ta kërkojë nëpërmjet ndeshjes së barazhit me skuadrën që kampionatin në Superligë e mbylli në pozitën e 8-të. Në këtë pozitë, pas ndeshjeve të javës së fundit të elitës, përfundoi Trepça '89.



Bushi: Dalim të dytët në grup, marrim Kumbullën ose Brojën

TRANË, 24 MAJ - Shqipëria U-21 do të luajë kundër Andorrës U-21 në kualifikueset e Evropianit dhe kundër Bullgarisë në miqësore. Trajneri Bushi u shpreh se do të marrë një tjetër element nga

Kombëtarja A që do ta pasurojë organikën për të dalë të dytët në grup. "Kemi marrë lojtarët që janë më në formë. Lojtarët e rinj duhet të kenë etje për Kombëtaren, jo lodhje. Jemi ekip në rritje. Për herë të

parë shumë vendin e tretë në sezonin e shkuar. Furnizua Kombëtaren A, ndërsa tani do ta kërkojmë vendin e dytë. Jam shumë i kënaqur me kampionatin shqiptar, se ka nxjerrë lojtarë të rinj. Përveç

Anglisë në grup, jemi të barabartë me gjithë të tjerët. Do të diskutoj me trajnerin dhe mund të marrim një lojtar nga Kombëtarja A që do ta bëjë diferencën, mund të jetë Broja ose Kumbulla", ka thënë Bushi.



Ramosi nuk merr ftesë nga Enrique: Më dhemb kur nuk mund ta përfaqësoj vendin tim

MADRID, 24 MAJ - Trajneri i Spanjës, Luis Enrique, ka konfirmuar një befasi të madhe në listën e të grumbulluarve për Kampionatin Evropian. Sergio Ramos, lojtari me më shumë ndeshje me përfaqësuesen, nuk do të jetë i pranishëm në turneun që do të nisë pas disa javësh. Kapiteni i Real Madridit u dëmtua në ndeshjen ndaj Chelseas në Ligën e Kampionëve dhe nuk ka luajtur me madrilenët ndeshjet e fundit të kampionatit. Mbrojtësi duket që ka zgjedhur që të marrë kohë për rikuperimin për të qenë gati për Lojërat Olimpikë, duke injoruar Evropianin.

Sergio Ramos ka thyer heshtjen pas vendimit për mosthirrjen e tij në Kampionatin Evropian "Euro 2020". "Pas disa muajve problematikë dhe një sezoni jonormal që është ndryshe nga ajo çfarë kam pasur përvojë në tërë karrierën time, përfshirë Kampionatin Evropian. Unë kam luftuar me mish e me shpirt çdo ditë që të jem 100 % me Real



LISTA E FUTBOLLISTËVE

Unai Simon, De Gea, Robert Sanchez, Gaya, Jordi Alba, Pau Torres, Laporte, Eric Garcia, Diego Llorente, Azpilicueta dhe Marcos Llorente. Busquets, Rodri, Pedri, Thiago, Koke, Fabian, Dani Olmo, Oyarzabal, Morata, Gerard Moreno, Ferran Torres, Adama Traore, Pablo Sarabia.

Madridin dhe Kombëtaren e Spanjës, por gjërat nuk shkojnë ashtu siç ku dëshironi", ka thënë

Ramos. "Më dhemb kur nuk mund ta ndihmoj skuadrën dhe ta mbroj Spanjën, por në këtë rast është më mirë të pushoj, të rikuperohem plotësisht, dhe në vitin tjetër të rikthehem ashtu siç kam bërë gjithmonë", ka deklaruar Ramos. "Më dhemb kur nuk mund të përfaqësoj vendin, por duhet të jem i sinqertë. U uroj fat të gjithë bashkëlojtarëve dhe shpresoj të kenë një Kampionat Evropian të madh. Do t'i mbështes nga shtëpia. Përsëritet për të gjithë", ka shtuar Ramos.

Lakersat e nisin me humbje fazën e 'play-off'-it

ARIZONA, 24 MAJ - Los Angeles Lakersi e nisi me humbje fazën e "play-off"-it në NBA duke komplikuar menjëherë misionin për ta mbrojtur titullin. Skuadra kaliforniane u mposht në Arizona nga Phoenix Suns me rezultatin 99-90, me kalifornianët që do ta kenë shumë të vështirë ta përsëritin suksesin e vitit të kaluar. Phoenix mori kryesimin e serisë në çerekfinalin e Perëndimit 1-0 ndaj lakersave për meritë edhe të Davon Bookerit i cili spikati me 37 pikë, 7 rebounde dhe 8 asistime. Poshtë pritshmërive dy jyet e LA Lakersit, me LeBron Jamesin që e mbylli ndeshjen me 18 pikë, ndërkohë që Anthony Davis shtoi vetëm 13 pikë. E nisi me këmbën e mbarë ndërkohë në Lindje, Philadelphia 76ers që mposhti në ndeshjen e parë të fazës "play-off" Washington Wizardsin me rezultatin 125-118. Tobias Harris me 37 pikë ishte heroi i



padiskutueshëm i 76ers në këtë sfidë, ndërkohë që te Washingtoni spikati Bradley Beal me 33 pikë, 10 rebounde dhe 6 asistime. Edhe sfida e dytë mes këtyre dy skuadrave do të luhet në "Wells Fargo Center" të Philadelphia. Surprizën e vërtetë të mbrëmjes së NBA-s e bëri Memphis Grizzlies që mposhti me rezultatin e ngushtë 112-109 brenda në Salt Lake City, Utah Jazz. Kanadezi Brooks me 31 pikë dhe Morant me 27 pikë ishin pa

diskutim dy më të mirët mbi parket për Memphisin, njëkohësisht dy basketbollistët më të rëndësishëm që morën për dore skuadrën nga Tennessee drejt këtij suksesi të rëndësishëm. Falë një super Trae Young arriti ta merrte kryesimin e serisë edhe Atlanta Hawksi që triumfoi 107-105 brenda në Madison Square Garden përballë New York Knicksit. Talenti i skuadrës nga Georgia Trae Young spikati me 32 pikë, 7 rebounde dhe 10 asistime.

SHKURT

Mediat turke: Shaqiri po vjen në Superligë

Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri duket se do të jetë ndër lojtarët e parë që do të largohet nga Liverpooli. Ylli nga Kosova nuk ka pasur një vit shumë të mirë te Liverpooli dhe trajneri Jurgen Klopp nuk po llogarit në shërbimet e tij për edicionin e ardhshëm derisa e ardhmja e tij pritet të jetë në elitën e futbollit turk.

Mediat turke e bëjnë të kryer kalimin e Shaqirit te Fenerbahçe. 'Fotomac' e ka cilësuar Xherdanin si një yll të madh të futbollit botëror që do t'i bashkohet Fenerit gjatë verës. Madje gazeta në fjalë tregon edhe detaje nga marrëveshja, ku Shaqiri pritet t'i bashkohet Fenerit si huazim me të drejtë blerje në verën e vitit 2022.

29-vjeçari nga Gjilani këtë edicion është paraqitur në 22 ndeshje zyrtare me Liverpoolin ku ka shënuar një gol të shënuar dhe ka bërë katër asistime. Po sipas mediumit në fjalë, në garë për Shaqirin është edhe gjiganti arab Al Hilal, skuadër ku luajnë edhe yjet si Sebastian Giovinco, Bafetimbi Gomis, Luciano Vietto dhe Andre Carillo.

Guardiola: Aguero transferohet në Barcelonë

Sergio Aguero është larguar nga Manchester City. Trajneri Pep Guardiola ka thënë se sulmuesi argentinasi me shumë gjasë do t'i bashkohet Barcelonës. "Ndoshta zbuloj një sekret, teksa them se Aguero është afër marrëveshjes me klubin e zemrës sime, Barcelona. Ai do të luajë përkrah lojtarit më të mirë të gjitha kohëve, Messi", ka thënë Guardiola. Sergio Aguero ka luajtur për Manchester Cityn nga viti 2011, duke regjistruar 275 paraqitje dhe ka shënuar 184 gola.

Reali e dëshiron Buffonin

E ardhmja e Gianluigi Buffonit është e gjitha për t'u vendosur, duke nisur pikësepari nga dëshira e vet portierit 43-vjeçar, por edhe nga oferta e çmendur (siç e ka deklaruar vetë italianin) që ai pret, ndonëse një e tillë duket se i ka ardhur tashmë. Por, çdo ditë që kalon horizonti pasurohet me risi të tjera dhe e fundit që vjen nga Spanja është thjesht bombastike. Sipas burimeve të "DonDiario", 43-vjeçari është në bisedime për t'u transferuar në Madrid, konkretisht te Reali për të pasur rolin e zëvendësimit të titullarit Thibaut Courtois, duke qenë se ukrainasi 22-vjeçar, Andriy Lunin, kërkon një aventurë si i parë diku tjetër. Kjo ofertë pa dyshim që josh shumë Buffonin, duke parë se është çdo vit favorit për ta tentuar Ligën e Kampionëve.

Koeman: Edhe kampionatin e ardhshëm do të jam trajner i Barçës

Trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, beson se do të vazhdojë të jetë trajner i "Blaugranëve". Barcelona doli nga gara për titull në dy ndeshjet e fundit ku u mposht nga Celta Vigo dhe barazoi me Atletico Madridin dhe Levanten duke përfunduar në vendin e tretë në La Liga. "Nuk besoj të jetë ndeshja ime e fundit me Barcelonën, kam një kontratë edhe për vitin e ardhshëm", ka thënë Koeman. "Jam i qetë, nëse klubi ka vendosur diçka ndryshe duhet të ma thotë. Kur i përgjigjeni për shumë kohë një pyetjeje, është normale që të jesh i lodhur", ka shtuar Koeman.

Kane, golashënuesi dhe asistuesi më i mirë i sezonit në Premierë Ligë

Sulmuesi i Tottenhamit, Harry Kane, është bërë lojtari i parë në 22 vjetët e fundit që i fiton çmimet për golashënuesin më të mirë dhe asistuesin më të mirë të një sezoni në Premierligë. Përfaqësuesi i Anglisë, i cili e ka shprehur dëshirën për t'u larguar nga klubi londinez në verë, i

shënoi 23 gola gjatë sezonit 2020/21 në Premierë Ligë, duke e fituar çmimin e golashënuesit më të mirë të sezonit për herë të tretë në karrierë. Rivali kryesor i Kane në garë për çmimin e golashënuesit më të mirë ishte Mohamed Salah. Ata u dytën me nga 22 gola në ditën e

fundit të sezonit në Premierligë. Por derisa Kane e shënoi një gol në fitoren e Tottenhamit 4:2 kundër Leicesterit, Salah dështoi të shënojë në fitoren e Liverpoolit 2:0 kundër Crystal Palaces. Kane e fitoi edhe çmimin e asistuesit më të mirë me 17 asiste. Kjo nënkupton se sulmuesi

anglez u përfshi në 37 gola këtë sezon në Premierligë. Kane e barazoi rekordin e të madhit Alan Shearer me tre trofe të golashënuesit më të mirë të sezonit në Premierligë, por ngel një mbrapa legjendës së Arsenalit, Thierry Henry, që e mban rekordin me katër.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
 për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 4265/20 të datës 24.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:
 Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
 Ndërtesa e Rilindjes
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
 Suzana.goranci@rks-gov.net
 Telefon: + 381 38 200 32 553



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë

Njoftim

Njoftojmë të interesuarit se me datën 02 Qershor 2021 (E Mërkurë) me fillim në orën 12:00 Inxh. i dipl. Ahmet Ahmeti mbron punimin e Masterit me titull “Vlera ushqyese e disa hibrideve të domates të kultivuar në mjedise të mbrojtura dhe në fushë të hapur në komunën e Drenasit”. Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Ragip (Sh) Ramadani, shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, 5 Gusht 2003.
- ▶ D.p.z Rrobaqepsi "Erblini" shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me nrb 70925362
- ▶ Marbles Sh.P.K shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me.nrb 811298084
- ▶ Liridon Musliu shpalle te pavlefshme certifikaten e leshuar nga qendra për aftesim profesional Mitrovice. Tik, nr protokolit 300/2015
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.

Nr. Prot. 106/21
Data 25/05/2021

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe të gjitha aktet tjera ligjore për ndryshim plotësimet e këtij ligji, si dhe bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, "Ndërmarrja Publike "Qendra Multifunkionale" SHA shpall:

K O N K U R S

KONKURS PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

- Përgjegjës për palestër sportive (1)
- Punëtorë teknikë- Ngrohje qendrore (1)

Entiteti: Qendra Multifunkionale SH.A

Vendi: Mitrovicë

Afati për aplikim (15) ditë nga data 25.05.2021 deri më 08.06.2021

Përshkrim

Qendra Multifunkionale SHA është ndërmarrje publike lokale në pronësi me 100% të aksioneve të saj nga Komuna e Mitrovicës. Të ardhurat e mëdha të kësaj ndërmarrje gjenerohen nga aktivitetet e hyrje-daljeve të ndërmarrjes. Qendra Multifunkionale SH.A. është në kërkim të stafit mbështetës-teknik të ndërmarrjes me kualifikim, me integritet të njohurive, përvojë të nevojshme profesionale që do të kujdesen në ndërmarrje në përputhje me parimet e njohura profesionale.

Vendi i punës: Përgjegjës për palestër sportive nr.reference 01/2021

- ◇ Diplomë e nivelit Bachelor, drejtimi Kulturë Fizike dhe Sport;
- ◇ Përvojë në lëminë e kërkuar, minimumi 3 muaj;
- ◇ Përparësi kanë personat që kanë trajnim-çertifikatë;
- ◇ Aftësi të mira komunikuese;
- ◇ Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip;
- ◇ Nivel të lartë të etikës profesionale
- ◇ Të punojë në orar fleksibil dhe të jetë i aftë të punojë nën presion.

Përgjegjësitë kryesore janë:

- ◇ Koordinon orarin e termineve për Palestrat dhe Sallën Sportive;
- ◇ Ofron shërbime si trajner sportiv, mban trajnime me fëmijë, këshillon në fushat përkatëse sportive;
- ◇ Mirëmban rregullisht hapësirat kryesore të Palestrave, Sallës si dhe hapësirave të tjera ndihmëse;
- ◇ Bashkëpunon me shkollat për caktimin e termineve;
- ◇ Mban evidencën e të gjitha termineve të mbajtura;
- ◇ Ofron shërbim të shkëlqyeshëm ndaj klientëve me qëllim të krijimit të një ambienti të hapur dhe miqësor;
- ◇ Raporton tek udhëheqësit;
- ◇ Si dhe angazhohet në shërbime të tjera sipas kërkesës së mbikeqyrësit në përputhje me natyrën e punës.
- ◇ Për punën e vetë i përgjigjet Ligjit, Udhëheqësit të tij, Kryeshefit Ekzekutiv.

Vendi i punës: Punëtor Teknik- Ngrohje qendrore nr.reference 02/2021

Përgaditja dhe shkathtësitë profesionale:

- ◇ Diplomë e shkollës së mesme Teknike
- ◇ Përparësi edukimi - Certifikimi në fushën e Ngrohjes Qendrore.
- ◇ Preferohet njohja e parimit të punës në sistemet konkrete (HVAC) apo të ngjashme.
- ◇ Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip.
- ◇ Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë ndërmarrjes.
- ◇ Nivel të lartë të motivimit, vet iniciativë dhe vëmendje në detaje.
- ◇ Nivel të lartë të etikës profesionale.

Përgjegjësitë kryesore janë:

- ◇ Bartësi i punës kryen punët ndihmësit në sistemin e ujësjellësit, kanalizimit gypave të ngrohjes qendrore dhe bën intervenimet sipas kërkesave të eprorëve të tij dhe inxhinierëve.
- ◇ Respekton udhëzimet për mirëmbajtje, të cilat janë përgatitura nga inxhinierët.
- ◇ Në konsultim me udhëheqësin e tij, kryen punët e mirëmbajtjes preventive në sistemin e ujësjellësit, kanalizimit dhe sistemin e ngrohjes qendrore, sipas nevojave dhe kërkesave.
- ◇ Intervenon në riparimet në raste të paraqitjes së avarive- defekteve në sistemin e gypave në tërësi.
- ◇ I përgjigjet çdo kohë thirrjes për intervenim dhe të vazhdoj punën sipas kërkesës.
- ◇ Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë personale. Kryen edhe punë të tjera me kërkesën e eprorëve të tij.
- ◇ Për punën e vetë i përgjigjet Ligjit, Udhëheqësit të tij, Kryeshefit Ekzekutiv.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacioni për punë
- CV-ja
- Dëshmia mbi përgaditjen profesionale
- Çertifikata e lindjes (origjinal)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Përvoja e punës nga lëmia profesionale (për pozitën që nevojiten)
- Vërtetimi se nuk jeni nën hetime dhe vërtetimi që nuk keni të kaluar kriminale.

Vërejtje: I gjithë dokumentacioni merret në Administratën e Qendrës Multifunkionale, si dhe duhet të dorëzohet i mbyllur në zarf.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë.

Sami Zeka



U.D. Kryeshef Ekzekutiv



Datë: 25.05.2021



Lume's Details

Estetik & Depilim






044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfën", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE

Mehmet Kraja



HËNA PREJ LETRE
(Drama, trilogji)



FATMIR LEKAJ

KOMBFORMIMI DHE PËRPJËKJET
E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI

një qasje teoriko-interpretuese



Fatmir Lekaj (1971) lindi në Pejë. Që tridhjetë vjet jeton në Norvegji. Fillimisht ka studiuar për të drejtat e njeriut dhe për trajtimin e konflikteve, ndërkohë edhe për shkencë politike. Ka magjistruar për shkencë politike në Universitetin e Oslos, kurse për studime postmagjistrale është përqendruar në temat që kanë të bëjnë me nacionalizmin, multikulturalizmin dhe integrimin. Merrat me veprimtari të kërkuesit të pavarur dhe të këshilldhënies për çështjet e integritetit etj. Është përkthyes i kualifikuar norvegjisht-shqip dhe sekretar i Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Norvegji.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

